



LEVIZAlbania
Demokracia Vendore në Veprim




#RUAJDISTANCËN #VENDOSMASKËN

UDHËZUES I THIRRJES PËR APLIKIME NR. 9

LevizAlbania

Një projekt i Agjencisë Zvicerane SDC



Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

ZBATUAR NGA





LEVIZAlbania
Demokracia Vendore në Veprim



#RUAJDISTANCËN #VENDOSMASKËN

Ky udhëzues shërben për të ofruar informacionet e nevojshme për të gjithë të interesuarit për të aplikuar me koncept-ide në Thirrjen për Aplikime Nr. 9, të LevizAlbania. Udhëzuesi shpjegon hapat, procedurat, dokumentacionin e kërkuar, rregullat dhe afatet e të gjithë procesit të Thirrjes, që nga hapja e saj, fazat pasardhëse dhe deri në përfundimin e saj.

Ky udhëzues është i rëndësishëm për të gjitha ato Organizata Jofitimprurëse Rinore dhe/ose për të Rinjtë, Grupe informale dhe Individë që janë të interesuar të aplikojnë pranë LevizAlbania. Për çdo informacion apo paqartësi mund të na shkruani në info@levizalbania.al ose na kontaktoni në numrin e telefonit +355 44 500 153.

1. Kush mund të aplikojë?

LevizAlbania mbështet përmes instrumentit të grantdhënies, Organizatat Jo Fitimprurëse (OJF)¹, Grupet Informale² dhe Individët.

Organizatat e shoqërisë civile (OJF) Rinore dhe/ose për të Rinjtë, organizatat me bazë në komunitet, organizatat e reja, grupet e të rinjve dhe të grave, individët apo grupimet e tyre, grupe të ndryshme interesi, etj, në zona urbane e rurale, janë të gjithë të ftuar dhe kanë mundësinë të aplikojnë në këtë thirrje.

Në seksionin 'Rregulla të Përgjithshme për Aplikimin dhe Informacion Shtesë' janë përcaktuar shprehimisht rastet e mospërputhshmërisë për të aplikuar në këtë thirrje.

Në Thirrjen për Aplikime Nr. 9 prioritet do të kenë aplikimet nga organizatat, grupet informale dhe individët të cilët nuk janë mbështetur më parë nga LevizAlbania.

2. Afati dhe mënyra e dorëzimit të aplikimeve:

Thirrja është e hapur nga data 13 Dhjetor 2021 deri në datën 13 Janar 2022 (ora 23:59).

¹OJF-të janë ato organizata që janë regjistruar dhe funksionojnë në përputhje me legjislacionin shqiptar, (ligji për regjistrimin e OJF Nr.8788, datë 7.5.2001) dhe ushtrojnë veprimtari në territorin e Shqipërisë.

²Grup informal është një grupim qytetesh aktivë që ndajnë të njëjtat vlera dhe parime, dhe që veprojnë sëbashku për të adresuar çështje e probleme social ekonomike në komunitetin dhe/ose fushën e tyre. Grupi informal nuk është i regjistruar në gjykatë dhe qëllimi i veprimtarisë së tij nuk është fitimprurës.



Aplikimi bëhet **VETËM** në formatin **ONLINE**. Për të aplikuar ONLINE duhet të vizitoni faqen zyrtare www.levizalbania.al dhe të klikoni në rubrikën Thirrja për Aplikime Nr. 9.

Formati i aplikimit ONLINE është i disponueshem në fund të tekstit të Thirrjes Nr. 9, të publikuar në këtë rubrikë.

Instruksione të rëndësishme për formatin e aplikimit ONLINE:

- Bëni kujdes në përzgjedhjen e një prej Drejtimeve të Thirrjes;
- Në përzgjedhjen e zonës së zbatimit, për më shumë se 1 (një) bashki duhet të mbani të shtypur në tastierën e kompjuterit butonin CTRL dhe më pas përmes MOUSE-it të përzgjidhni bashkitë e planifikuara. Në rast se idea juaj ka një shtrirje kombëtare, ky opsion ndodhet në krye të kategorisë “zona e zbatimit”. Në aplikimet përmes telefonit celular mjafton të klikoni njëherë mbi çdo bashki për përzgjedhjen e shumëfishhtë;
- Në vendosjen e vlerës financiare të kërkuar për mbështetjen e koncept-idesë, në këtë fazë të aplikimit duhet vendosur vetëm një vlerë numerike, shembull: 25500 (pa presje dhjetore, pa pika, pa viza në pjesën e poshtme të numrave apo në mesin e tyre);
- Respektoni numrin e karaktereve për secilën fushë që duhet të plotësoni. Numri ndryshon për secilën prej fushave boshe sipas specifikimeve përkatëse, dhe në rast të tejkalimit të tij, sistemi nuk do t’ju lejojë të vijoni shkrimin;
- Aplikanti OJF, duhet të ngarkojë gjatë aplikimit vendimin më të fundit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë mbi organizatën, në formatin JPG (fotografi) ose PDF;
- Aplikanti GRUP INFORMAL, duhet të ngarkojë gjatë aplikimit një CV të personit që drejton/koordinon Grupin, si dhe një CV të vetë Grupit informal (duke përfshirë aktivitete të mëparshme të grupit, si dhe emrat e anëtarëve të grupit), në formatin PDF ose Microsoft Word;
- Aplikanti INDIVID, duhet të ngarkojë gjatë aplikimit CV-në përkatëse, në formatin PDF ose Microsoft Word;
- **KUJDES:** Të gjitha fushat për tu plotësuar gjatë aplikimit janë të shënuara me shenjën* (Asterix) dhe janë të detyrueshme për tu plotësuar. Në rast të mos plotësimit të këtyre fushave nuk do të lejoheni të përfundoni APLIKIMIN tuaj;
- Në përfundim mjafton të klikoni “APLIKO” dhe keni përfunduar;
- Pas dërgimit të aplikimit do t’ju mbërrijë në adresën e postës elektronike të vendosur në aplikim, mesazhi nga serveri i LevizAlbania: “Faleminderit që Aplikuat” dhe bashkëlidhur do të jetë një kopje e aplikimit. Vetëm marrja e emailit konfirmon se aplikimi juaj ka mbërritur pranë LevizAlbania dhe ka qenë i suksesshëm.



LEVIZAlbania
Demokracia Vendore në Veprim



#RUAJDISTANCËN #VENDOSMASKËN

3. Drejtimit e Thirrjes

Kujdes: Drejtimit e Thirrjes përfaqësojnë objektivat që LevizAlbania synon të arrijë përmes ideve/nismave në kuadër të mbështetjes së aktorëve të shoqërisë civile, grupimeve informale dhe individëve.

LevizAlbania synon të forcojë demokracinë vendore në Shqipëri përmes angazhimit të shoqërisë civile dhe individëve si kampionë të demokracisë për një qeverisje cilësore.

LevizAlbania është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) që zbatohet nga konsorciumi i tre organizatave shqiptare: "Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë", "Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim" dhe "Co-PLAN".

LevizAlbania fton Organizatat JoFitimprurëse (OJF)³ Rinore dhe/ose për të Rinjt, Grupet infomale⁴ dhe Individët të aplikojnë me koncept-ide në Thirrjen për Aplikime Nr. 9 me qëllim: përmirësimin e demokracisë vendore dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve në nivel vendor.

Rritja e aktivizmit rinor është një nga instrumentat kryesor që mundëson ndryshime strukturore, edhe në nivel vendor, përsa i përket marrëdhënies së qytetarëve me komunitetin dhe qeverisjen.

*Prandaj, fokusi i Thirrjes për Aplikime Nr.9 të LevizAlbania është **mbështetja dhe potencimi i të rinjve aktiv në komunitet** që përhapin ndjenjën komunitare, mbështesin aktivizmin qytetar dhe ndërmarrin nisma konkrete për zgjidhjen e problemeve të hasura në komunitet.*

Të interesuarit ftohen të dërgojnë **KONCEPT IDE** bazuar në drejtimit e mëposhtme:

Drejtimi 1: Aktivizëm rinor në adresimin e problematikave konkrete dhe rritjen e pjesëmarrjes rinore në nivel vendor.

Drejtimi 2: Komunitete aktive në ripërtëritjen e vlerave mjedisore në nivel vendor.

Drejtimi 3: Të rinjtë në aksione komunitare.

Grupet e targetuara: Të rinjtë⁵ në bashki periferike, komunitetet lokale në zonat rurale, gratë dhe vajzat, dhe grupet e marginalizuara.

³ OJF-të janë ato organizata që janë regjistruar dhe funksionojnë në përputhje me legjislacionin shqiptar, (ligji për regjistrimin e OJF Nr.8788, datë 7.5.2001) dhe ushtrojnë veprimtari në territorin e Shqipërisë.

⁴ Grup informal është një grupim qytetaresh aktivë që ndajnë të njëjtat vlera dhe parime, dhe që veprojnë së bashku për të adresuar çështje e probleme social ekonomike në komunitetin dhe/ose fushën e tyre. Grupi informal nuk është i regjistruar në gjykatë dhe qëllimi i veprimtarisë së tij nuk është fitimprurës.

⁵ Ligji nr.75/2019 "Për rininë", Datë. 4.11.2019), përcaktimi i të rinjve moshat 15-29 vjeç.



Drejtimi I: Aktivizëm rinor në adresimin e problematikave konkrete dhe rritjen e pjesëmarrjes rinore në nivel vendor.

Mungesa e informacionit të të rinjve mbi instrumentet në dispozicion të tyre, përbën një nga problemet kryesore nga ku buron mospërfshirja në proceset vendim-marrëse, sidomos në bashkitë e vogla dhe zonat rurale. Zhvillimet e viteve të fundit në fushën e rinisë kanë ndryshuar disa struktura të bashkëveprimit të pushtetit vendor me shoqërinë civile për të cilat të rinjtë kanë informacion të cunguar. Konkretisht, në vijim të miratimit të Ligjit për Rininë⁶, strukturat e pushtetit vendor kanë përfituar kompetenca të reja dhe më shumë përgjegjësi për të sktruktuar funksionimin e tyre përse i përket këtij sektori. Zbatimi i parashikimeve të ligjit dhe ngritjes së stukturave të reja është ende një proces që po vijon dhe që ka nevojë për ndërgjegjësim dhe informim si për strukturat e pushtetit vendor, ashtu edhe për qytetarët dhe organizatat rinore. Rrjedhimisht çelësi i suksesit i të gjitha nismave të synuara nën këtë drejtim është pjesëmarrja aktive rinore e cila bazohet në informimin, kapacitimin dhe akoma më e rëndësishme në përfshirjen reale dhe aktive në nisma konkrete që japin shembullin e mirë të përfshirjes së të rinjve në komunitet.

LA do të mbështesë organizatat rinore në ndërhyrje për adresimin e mungesës së informacionit tek të rinjtë. Rëndësi të veçantë duhet të zërë shpërndarja e informacionit tek të rinjtë duke e bërë atë sa më të rrjetëzuar e të mirëorganizuar. Të rinjtë e moshës së arsimit të mesëm dhe sidomos të moshës së arsimit universitar duhet të jenë në fokus të këtyre ndërhyrjeve informuese, dhe të rritjes së kapaciteteve/përfshirjes nëpërmjet modeleve konkrete të zbatimit rreth pjesëmarrjes aktive në vendim-marrje e politikëbërje.

Qëllimi i këtij drejtimi është **angazhimi rinor në nivel vendor, zhvillimi i mendimit kritik, që nxit frymën e aktivizmit** tek të rinjtë nëpërmjet /informimit, ushqen potencialin e tyre për të sjellë ndryshime pozitive, siguron pjesëmarrjen aktive dhe angazhimin e të rinjve në proceset e vendim-marrjes dhe promovon vullnetarizmin nëpërmjet përfshirjes së të rinjve, si vullnetarë në aktivitetet që do të organizohen.

Veprimtari/Idetë të sugjeruara për realizimin e këtij drejtimi janë (por jo të kufizuara në sa më poshtë):

- Angazhimi i të rinjve në transformimin e qendrave rinore (aty ku ekzistojnë) në 'nyje sociale' që mundësojnë ndërlidhshmëri, duke mundësuar më shumë aftësim dhe pjesëmarrje rinore në komunitetet ku jetojnë;

⁶ Ligji për Rininë (Nr. 75, Datë. 4.11.2019), synon ndër të tjera rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset e vendim-marrjes në nivelin qendror dhe vendor.



- Përdorim i praktikave të edukimit joformal, si pjesëmarrja gjithëpërfshirëse dhe vullnetare në nisma të përbashkëta, si aktivitete të të mësuarit nga bashkëmoshatarët që trajtojnë shëndetin mendor dhe fizik; promovimit të jetesës aktive në natyrë, duke përfshirë zakonet e të ushqyerit të shëndetshëm dhe të kujdesit për veten, etj;
- Promovimi i pjesëmarrjes në qeverisjen vendore, përmes zhvillimit të kulturës së debatit konstruktiv, duke theksuar rolin e të rinjve si agjentë të zhvillimit përmes aktiviteteve vullnetare, nxitjes së formimit të grupeve grupeve me ndikim në nisma specifike, sesioneve të ngritjes së kapaciteteve për fuqizimin e zërit të të rinjve, etj;
- Forume/Maratonat e aktivizmit rinor ku ligjërimet/trainimet me natyrë teorike do të shoqërohen dhe testohen në praktikë për të nxitur aktivizmin e të rinjve në nivel vendor:
 - (i) Ngritje kapacitetesh individuale për format e aktivizimit dhe teknikat e shfrytëzimit të të dhënave në mbështetjen e synimeve advokuese;
 - (ii) Mbështetje e vazhdueshme në zbatimin e iniciativave personale në funksion të rritjes së aktivizimit qytetar në shkallë më të gjerë.

E rëndësishme: Tërësia e veprimtarive/përqasjes së mësipërme duhet reflektuar në ide të cilat mundësojnë zbatimin e modeleve të aktivizmit, pjesëmarrjes dhe aftësisë rinor dhe shpërndarjen e strukturuar të njohurive të përfituara me aktorët e interesuar.

Drejtimi 2: Komunitete aktive në ripërtëritjen e vlerave mjedisore në nivel vendor.

Kapitali shoqëror dhe sidomos zotërimi i vlerave mjedisore kërkojnë breza për tu ndërtuar, por mund të shkërmoqen lehtësisht. Për shkak të zhvendosjeve masive demografike, të brendshme dhe të jashtme, kapitali shoqëror i Shqipërisë dhe veçanërisht zotërimi i vlerave mjedisore janë dobësuar ndjeshëm. Ky fenomen është reflektuar, ndër të tjera, edhe në marrëdhënien abuzive dhe shkatërruese me mjedisin natyror, që i ka dhënë jetë një cikli vicioz të abuzimit dhe degradimit mjedisor me efekte të dëmshme për shumë komunitete anë e kënd Shqipërisë. Thyerja e këtij ‘qarku veskeq’ kërkon ripërtëritjen e kapitalit shoqëror e veçanërisht të vlerave mjedisore. Shtresa shoqërore ku ka më shumë mundësi thyerja e këtij ‘qarku veskeq’ dhe ripërtëritja e vlerave të shëndetshme mjedisore është rinia.

Bazuar në sa më sipër, qëllimi kryesor i këtij drejtimi është ripërtëritja e identiteteve dhe vlerave mjedisore vendore dhe përvetësimi i tyre nga të rinjtë për të krijuar një marrëdhënie më të qëndrueshme me natyrën. Ndërhyrjet në këtë drejtim duhet të zbatohen modele dhe aksione konkrete të cilat mundësojnë krijimin e



LEVIZAlbania
Demokracia Vendore në Veprim



#RUAJDISTANCËN #VENDOSMASKËN

një përfaqëse të re komunitare bazuar në specifikat mjedisore vendore, që mundësojnë një marrëdhënie më të qëndrueshme me ambientin në nivel vendor.

Veprimtari/Idetë të sugjeruara për realizimin e këtij drejtimi janë (por jo të kufizuara në sa më poshtë):

- Rinia e përfshirë në zbatimin e nismave konkrete për të ruajtur dhe mbrojtur aktivisht mjedisin dhe biodiversitetin, peisazhet natyrore dhe zonat e mbrojtura në nivel vendor;
- Njohja dhe vlerësimi i identiteteve dhe vlerave mjedisore vendore dhe ndërtimi i një vizioni afatgjatë për rivitalizimin e tyre;
- Mbledhja dhe përçimi i gojëdhënave dhe 'zërave të të vjetërve' (ose elementëve të tjerë etnografikë) mbi bashkëveprimin e komunitetit me natyrën;
- Organizimi i aktiviteteve/festivaleve vendore me fokus natyrën dhe ndërgjegjësimin për fuqinë e komunitetit vendor;
- Advokimi dhe litigimi për mbrojtjen e mjedisit/ndryshimet e klimës;
- Edukimi ligjor i komuniteteve/të rinjve lidhur me mbrojtjen e mjedisit/ndryshimet e klimës.

E rëndësishme: Tërësia e veprimtarive/përfaqësjes së mësipërme duhet reflektuar në ide të cilat mundësojnë zbatimin e modeleve të aktivizmit të të rinjve/komunitetit në mbështetje të ripërtëritjes së vlerave mjedisore në nivel vendor për të mundësuar mbrojtjen e mjedisit dhe luftuar ndryshimet e klimës. Të gjitha nismat duhet të shoqërohen me një shpërndarje të strukturuar të njohurive të fituara me të gjithë aktorët e interesuar.

Drejtimi 3: Të rinjtë në askione komunitare

Është fakt që të synosh një qytetari aktive, në mënyrë që të përftohesh Reagim Qytetar, duhet filluar duke angazhuar të rinjtë në aktivitete qytetare, siç është shërbimi në komunitet dhe puna vullnetare. Të rinjtë i kanë të gjitha premiset të jenë qytetarë aktivë e përçues të ndryshimeve pozitive në komunitet përsa i përket shkollës, mjedisit dhe shoqërisë në tërësi nëpërmjet aksioneve të strukturuar vullnetare. Veprimet 'e vogla' shërbejnë si shembuj nga ku mund të lindin ndryshimet e mëdha në komunitet.

Një problematikë e evidentuar shpesh nga ndërhyrjet që LA ka mbështetur është mungesa e informacionit. P.sh: një pjesë e mirë e qytetarëve nuk dinë akoma se tarifa e pastrimit që ata paguajnë mbulon heqjen e mbetjeve urbane nga pika e grumbullimit dhe jo pastrimin e mbeturinave që shkaktohen nga ndërgjegjia e ulët mjedisore e disa banorëve, apo se pastërtia e mjedisit rreth banesave është përgjegjësi e tyre si banorë dhe qytetarë. Pra një hap i rëndësishëm për të arritur një qytetari aktive është dhe ndërgjegjësimi i publikut.



LEVIZAlbania
Demokracia Vendore në Veprim



#RUAJDISTANCËN #VENDOSMASKËN

Bazuar në këtë këndvështrim LA ka mbështetur ndër vite dhjetra individë (kampionë të demokracisë vendore) në zbatimin e nismave 'të thjeshta' dhe mjaft rezultative. Edhe në këtë thirrje LA vazhdon mbështetjen ndaj individëve sidomos të rinjtë të cilët adresojnë nëpërmjet aksioneve komunitare (psh: aksione pastrimi me të rinj vullnetarë) problematika të komuniteteve ku jetojnë.

LA synon që nëpërmjet mbështetjes së të rinjve në komunitet të nxitet aksioni komunitar të kultivohet dhe energjizohet ndërgjegjësimi nëpërmjet informimit dhe të forcohet përkatësia komunitare nëpërmjet përfshirjes në aksione konkrete si modeli më i mirë i angazhimit dhe ndërveprimit.

Për sa më sipër ky drejtim ofron mbështetje për të rinjtë të cilët nxisin ndryshimin, për aksione qytetare në komunitete që ndohen ne lagje, fshat etj. , të cilat ndajnë një shqetësim apo problematikë, dhe kanë nevojë për koordinim/organizim drejt nismave/veprimeve konkrete në përmirësim të mjedisit ku jetojnë.

Grantet nën këtë drejtim ofrojnë një financim bazë dhe do të shoqërohen me mentorim dhe mbështetje teknike nga LevizAlbania gjatë zbatimit të projektit.

ARSYETIMI

LevizAlbania (LA) nga 2015 ka shpallur **8 Thirrje për Aplikime**, nëpërmjet të cilave organizatat e shoqërisë civile, grupet informale dhe individët janë mbështetur në zbatimin e nismave konkrete dhe inovative me synim përmirësimin e demokracisë vendore dhe rritjen e angazhimit qytetar. Përgjatë këtyre viteve janë vlerësuar 2,329 aplikime, nga të cilat janë financuar 249 ndërhyrje. Po aq e rëndësishme dhe ndryshe nga projektet e tjera, LA mbështet drejtpërdrejtë individët dhe grupet informale. 818 individë dhe grupe informale kanë aplikuar me ide konkrete për përmirësimin e demokracisë në komunitet e tyre. Ky interesim tregon se gatishmëria për qytetari aktive është e pranishme në komunitete anë e kënd Shqipërisë.

Përveç besimit tek LA dhe gatishmërisë për të marrë përsipër fatet e komuniteteve të tyre, analiza e aplikimeve të ardhura nga organizatat e shoqërisë civile, grupet informale dhe individët, ka nxjerr në pah disa tendenca mbi problematikat dhe nevojat për mbështetje nga këndvështrimi i qytetarëve. Specifikisht, që nga 2015 gati 26% e aplikimeve kanë të bëjnë me rininë, reflektuar në çështje që lidhen me fuqizimin, përfshirjen në dhe aktivizimin për përmirësimin e komuniteteve ku ato jetojnë, si dhe aftësimin për sfidat e të ardhmes.



LEVIZAlbania
Demokracia Vendore në Veprim



#RUAJDISTANCËN #VENDOSMASKËN

Bazuar në sa më sipër, si dhe duke analizuar zhvillimet më të fundit në sektorin e rinisë, LA ia dedikon Thirrjen për Aplikime Nr. 9 aktivizmit rinor në nivel vendor duke mbështetur ide/nisma të aktorëve të shoqërisë civile, grupeve informale dhe individëve. Këto ide synohet të mundësojnë dhe potencojnë aktivizmin rinor në komunitete anë e kënd Shqipërisë që reflektohet në pjesëmarrje masive rinore dhe veprimtari konkrete.

Shqipëria⁷, në krahasim me vendet e tjera evropiane, mbetet një vend me moshë mesatare të re ku rreth 24% e popullatës dominohet nga moshë 15-29 vjeç e cila përbën grupimin më të madh të forcës aktive në shoqëri dhe forcës së aftë për punë. Edhe pse të rinjtë kanë qenë në vëmendjen e politikave të qeverive shqiptare⁸, ata ende përballen me sfida të mëdha strukturore si përfshirja në proceset vendimmarrëse dhe demokratike, punësimi, edukimi, kujdesi shëndetësor, përfshirja sociale, etj.

Sfidat me të cilat përballen të rinjtë shqiptarë burojnë nga ajo që shumë studiues e quajnë si “kriza e përfaqësimit në demokraci”. Gjithnjë e më shumë të rinjtë tregojnë interes të ulët ndaj proceseve politike dhe vendimmarrëse reflektuar në apati dhe indiferencë. Apatia rinore dhe mos angazhimi në proceset vendimmarrëse mbetet ndër problemet kyçe të shumë komuniteteve në Shqipëri. Një studim i Fondacionit Friedrich Ebert⁹, dëshmon për një shkallë të ulët të angazhimit dhe të përgjegjësisë sociale të të rinjve, ku rreth 80% deklarojnë se nuk kanë marrë pjesë në ndonjë nismë qytetare. Si rrjedhojë, me kalimin e kohës, është krijuar një ‘qark vesqej’ dhe vetë-forcues ku problemet me të cilat të rinjtë përballen krijojnë mosbesim e mospjesëmarrje që më pas ndikojnë në mos adresimin e problemeve. Prandaj, ndërjegjësimi i të rinjve dhe pjesëmarrja aktive e tyre në komunitetet ku ato jetojnë është thelbësore për Shqipërinë si hap i domosdoshëm për zëvendësimin e apatisë me aktivizëm.

Fokusi i Thirrjes për Aplikime Nr.9 tek mbështetja dhe fuqizimi i të rinjve aktiv në komunitet, përveç se adreson një nevojë reale, krijon sinergji dhe me zhvillime të tjera të rëndësishme në fushën e politikave rinore. Specifikisht, përgjatë vitit 2022 Tirana do jetë Kryeqyteti Evropian i Rinisë, çka do të thotë shumë projekte, aktivitete, promovim i i Tiranës dhe Shqipërisë, dhe shumë mundësi për të rinjtë për t’u organizuar dhe lidhur me rrjetet rinore evropiane. Nëpërmjet aktiviteteve që do të organizohen nga kjo Platformë synohet: (i) krijimi i mundësive të reja; (ii) inkurajimi i pjesëmarrjes aktive; (iii) promovimi i vullnetarizmit; (iv) nxitja e identitetit evropian; (v) mbështetja e larmishmërisë dhe përfshirjes; (vi) rritja e investimeve të mundshme për rininë; (vii) shndërrimi i kryeqytetit në një pikë takimi ndërkombëtar, etj. Në mënyra të ndryshme, pjesa kryesore e objektivave të mësipërm janë mbështetur nga LA në të gjithë Shqipërinë përgjatë këtyre 7 viteve.

Megjithatë një realitet ndryshe – dhe shumë më sfidues – me kryeqytetin është prezent në bashkitë e tjera të vendit. Bashkitë e riorganizuar, sidomos ato periferike me mundësi të kufizuara dhe popullsi

⁷ https://www.un.org.al/sites/default/files/plani%20kombetar%20i%20veprimit%20per%20rinine%202015-2020_Shqip.pdf

⁸ Krijimi i Ministrisë së Rinisë dhe Fëmijëve dhe puna që po zhvillohet për strategjinë e re të rinisë janë disa tregues të përpjekjeve në nivel qendror për të adresuar disa nga problemet strukturore me të cilat përballen rinia në Shqipëri.

⁹ <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/15257.pdf>



rinore në tkurrje, kanë hasur vështirësi të krijojnë struktura dhe programe funksionale për angazhimin e të rinjve si instrument për aftësimin e tyre dhe përçimin e vlerave të qëndrueshme qytetare. Mungesa e burimeve, njohurive dhe fokusit në politikat rinore në nivel vendor ka penguar krijimin e një mjedisi mundësues për përfshirjen e tyre, qoftë në çështje që kanë të bëjnë me qeverisjen, apo aktivitete të tjera, që synojnë nxitjen e angazhimit dhe zhvillimit profesional. Në kushtet e tkurrjes së popullsisë rinore, emigracionit, uljes së lindshmërisë dhe apatisë rinore – sidomos në zonat larg Tiranës – bëhet edhe më e domosdoshme targetimi dhe përfshirja e të rinjve në aktivitete të cilat pasurojnë jetën shoqërore, forcojnë lidhjet komunitare dhe i mundësojnë të rinjve të njohin veten, zbulojnë/kultivojnë talentet dhe krijojnë lidhje shoqërore, duke rritur kështu gjasat që ata jo vetëm të mos largohen, por të jenë kontribues aktivë në komunitetet ku jetojnë.

Bazuar në gjithë sa më sipër, Thirrja për Aplikime Nr.9 e LevizAlbania i kushtohet mbështetjes dhe potencimit të rinisë aktive për adresimin e problemeve konkrete në komunitetet ku ato jetojnë, sidomos **në zonat periferike larg Tiranës**. Kjo mbështetje synon transformimin e 2022 në vitin e rinisë aktive, edhe jashtë Tiranës, dhe zbatimin të modeleve të cilat mundësojnë zgjidhjen e problemeve konkrete dhe strukturore me të cilat përballet rinia në Shqipëri.

4. Kushtet për aplikim, madhësia e granteve dhe afati i zbatimit

- Prioritet do të kenë aplikimet nga organizatat, grupet informale dhe individët të cilët nuk janë mbështetur më parë nga LevizAlbania;
- Drejtimit 1 dhe 2 janë të hapura për OJF-të Rinore dhe/ose për të Rinjtë të regjistruara sipas legjislacionit shqiptar në fuqi;
- Grupet Informale mund të aplikojnë vetëm në Drejtimit 2 dhe 3;
- Individët mund të aplikojnë vetëm në Drejtimin 3;
- OJF-të që aplikojnë në Drejtimin 1 dhe 2 mund të zbatojnë projekte vetëm në qarkun ku operojnë. Në rastin e partneriteteve, lideri duhet të jetë OJF-ja e bazuar në qarkun ku zbatohet projekti.
- Ndërhyrjet e propozuara në Drejtimit 1 dhe 2 duhet të targetojnë bashki brënda një Qarku.
- Grupet Informale dhe Individët mund të aplikojnë me koncept ide që propozojnë ndërhyrje vetëm në Bashkinë ku banojnë;
- Grantet për OJF do të variojnë nga **10,000 CHF** deri në **60,000 CHF**;
- Kufiri maksimal i granteve për Grupet Informale është **10,000 CHF**;
- Kufiri maksimal i granteve për Individë është **7,000 CHF**;
- Afati maksimal i zbatimit të projektit është **10 muaj**.



E rëndësishme: LevizAlbania gjatë fazës së dytë ka financuar ndërhyrje në 54 bashki. Për të siguruar një shtrirje gjeografike më të gjerë me ndërhyrje që shtrihen në të gjithë territorin e vendit do të konsiderohen me vlerë të shtuar koncept-idetë që targetojnë bashki nga lista që vijon: Tepelenë, Libohovë, Delvinë, Dropull, Këlcyrë, Memaliaj dhe Finiq

5. Kriteret e Vlerësimit

Kriteret kryesore për vlerësimin e koncept-ideve janë si më poshtë vijon:

- Përputhja e konceptidesë me drejtimet/objektivat e thirrjes;
- Kuptueshmëri e mirëformular e problemit të identifikuar dhe adresim i duhur i tij (mungesa e identifikimit të qartë të problemit, përjashton koncept-idenë nga vlerësimi i mëtejshëm);
- Qartësi dhe lidhje logjike në përcaktimin e qëllimit kryesor dhe objektiveve specifike;
- Strukturimi dhe planifikimi i aktiviteteve, si dhe lidhja logjike e tyre me objektivat dhe rezultatet e pritshme;
- Vlera e shtuar dhe risia që sjell ndërhyrja e propozuar.

6. Rregulla të Përgjithshme për Aplikimin dhe Informacion Shtesë

- OJF-të Rinore dhe/ose për të rinjtë, grupet informale dhe individët janë të lejuar të aplikojnë vetëm me një projekt-ide;
- Ndërhyrjet e propozuara në një Bashki (ose komunitet) të caktuar propozohen nga individë/grupe informale/organizata që banojnë/kanë selinë në të njëjtin Qark;
- Organizatat lokale duhet të kenë rolin e liderit në aplikim, në zbatimin e ndërhyrjes dhe në administrimin e buxhetit, e cila do të pasqyrohet edhe në kontratën e grantit.
- Grantmarrës aktualë të LevizAlbania të cilët janë duke zbatuar një projekt grant të financuar nga LA gjatë periudhës që thirrja qëndron e hapur nuk mund të pranohen të aplikojnë.
- Nuk mund të pranohen aplikime/koncept-ide nga shoqatat e njësisve vendore.
- Nuk mund të pranohen aplikime/koncept-ide nga organizata të shoqërisë civile që kanë të përfshirë në strukturat e tyre, apo në grupet e punës të propozuar:
 - persona që janë në një konflikt interesi, në lidhje me statusin e tyre profesional ose personal;
 - persona që janë të punësuar në projekte të Organizatave/Donatorëve Ndërkombëtarë;
 - persona që janë të punësuar në administratën publike apo që janë pjesë e organeve të zgjedhura qendrore apo vendore;



LEVIZAlbania
Demokracia Vendore në Veprim



#RUAJDISTANCËN #VENDOSMASKËN

- Rregulli i mësipërm vlen edhe për aplikuesit individë apo grupe informale, të cilët duhet gjithashtu të deklarojnë se nuk janë në një nga kushtet e përmendura më sipër.
- OJF-të Rinore dhe/ose për të rinjt, duhet të paraqesin vendimin më të fundit të marrë nga Gjykata, lidhur me statusin e tyre;
- Grupet informale që aplikojnë për Drejtimin 2 ose 3, duhet të dërgojnë CV-të grupit (pasqyrim i aktiviteteve të kaluara të grupit si dhe emrat e anëtarëve kryesorë të tij), si dhe CV-në e koordinatorsit apo përfaqësuesit të grupit për këtë projekt propozim;
- Individët që aplikojnë për Drejtimin 3 duhet të dërgojnë CV e tyre (vetëm CV-në e individit aplikant);
- LevizAlbania nuk njeh si shpenzim të projektit Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH).

LevizAlbania kërkon nga aplikantët që në hartimin e koncept-ideve të tyre:


- të përfshijnë **perspektivën gjinore**;
- të ideojnë ndërhyrje me **aksione konkrete** në terren;
- të **stimulojnë vullnetarizmin**;
- të përfshijnë **grupet e targetuara**: të rinjtë në bashki periferike, komunitetet lokale në zonat rurale, gratë dhe vajzat, dhe grupet e marginalizuara.
- të **bashkëpunojnë me gazetarë dhe media** për të advokuar apo për të shpërndarë në publik mesazhet kryesore;
- të konsiderojnë në koncept-ide **bashkepunime** me organizata të tjera, individë dhe/ose grupe informale **me qëllim krijimin e koalicioneve të mundëshme**.

LevizAlbania NUK mbështet projekte/aktivitete që synojnë:

- Ofrimin e shërbimeve sociale;
- Realizimin e kompetencave/detyrave të pushtetit vendor;
- Trajnime të administratës vendore;
- Vetëm dhe kryesisht zhvillimin e tryezave të rrumbullakta / seminareve që nuk sjellin rezultat konkret e të prekshëm për qytetarët.

7. Hapat e Thirrjes për Aplikime Nr. 9

Mekanizmi i përzgjedhjes së projekteve më të mira të Thirrjes për Aplikime Nr. 9 të LevizAlbania kalon në tre faza që sigurojnë transparencë, përfshirjen e grupeve të interesit dhe cilësi të lartë të aplikimeve, të cilat duhet të jenë në përputhje me drejtimet e thirrjes.



- **Informimi dhe Komunikimi për Thirrjen për Aplikime 9**

Gjatë periudhës kur Thirrja për Aplikime Nr. 9 do të qëndrojë e hapur, LevizAlbania do të organizojë 4 (katër) sesione informuese në të cilat janë të ftuara organizata të shoqërisë civile, grupe informale, individë dhe dhe të gjitha kategoritë e përmendura në fillim të udhëzuesit. Sesionet synojnë të informojnë dhe të rrisin njohuritë e aplikantëve që janë të interesuar për të aplikuar. Në sesionet informuese do të diskutohet mbi tematikat e drejtimeve dhe procedurat e thirrjes dhe do t'i jepet përgjigje të gjitha pyetjeve që kanë të interesuarit mbi Thirrjen për Aplikime. Sesionet informuese do të zhvillohen si më poshtë:

14 Dhjetor, 2021, në Gjirokastrë	ora 11.00 deri në 13:00
21 Dhjetor, 2021, në Lezhë	ora 11.00 deri në 13:00
28 Dhjetor, 2021 online	ora 11.00 deri në 13:00
7 Janar, 2022 në Durrës	ora 11.00 deri në 13:00

Gjithashtu, për të siguruar një informacion sa më të gjerë për aplikantët e interesuar, LevizAlbania gjatë periudhës së Thirrjes Nr. 9 do të përfshijë në websiten e projektit link një seksion të dedikuar për Pyetje/ Përgjigje të Shpeshta.



LEVIZAlbania
Demokracia Vendore në Veprim



#RUAJDISTANCËN #VENDOSMASKËN

- **Vlerësimi i koncept ideve**

Vlerësimi i konceptideve bëhet me pikë për secilin kriter. Nga ky vlerësim do të përzgjidhen aplikantët më cilësorë, të cilët do të ftohen të marrin pjesë në Konkurset e Ideve. Aplikantët të cilët nuk do të mund të vazhdojnë më tej procesin e konkurrimit, do të njoftohen me shkrim për vendimin dhe vlerësimin me pikë.

- **Konkurset e Ideve**

Aplikantët e përzgjedhur do të ftohen të prezantojnë koncept-idenë e tyre gjatë Konkursit të Ideve. Konkurset e Ideve zhvillohen si rregull në tre qytete të ndryshme, megjithatë në varësi të situatës në vend, LevizAlbania vendos zhvillimin e Konkursit të Ideve përmes platformave të teknologjisë së informacionit.

Bordi i Granteve i përbërë nga përfaqësues dhe ekspertë të njohur të shoqërisë civile, qeverisjes vendore dhe medias nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut, do të përzgjedhë idetë më cilësore që do të kalojnë në fazën e fundit, atë të hartimit të projektpropozimeve të plota.

Konkurset e Ideve janë të hapura për të gjithë aplikantët dhe të interesuarit dhe do të transmetohen drejtpërsëdrejti në kanalet e komunikimit të LevizAlbania.

- **Përgatitja dhe vlerësimi i Projekt Propozimeve të Plota**

Gjatë kësaj faze aplikantët e përzgjedhur gjatë Konkurseve të Ideve do të përgatisin projektin e plotë, duke pasqyruar sugjerimet dhe komentet e bëra nga Bordi i Granteve. Bordi i Granteve do të vlerësojë projekt propozimet e plota dhe do të marrë vendimin për fituesit. Kriteret e vlerësimit të Projekt Propozimeve të plota janë si më poshtë:

- Reflektim i rekomandimeve të Bordit të Grantit gjatë Konkurseve të Ideve;
- Vlerësim i kapaciteteve menaxhuese, financiare dhe ekspertizës së organizatës/grupit informal/individit;
- Përputhja e buxhetit me objektivat dhe aktivitetet e projektit.

Identifikimi i problemit është kyç për suksesin e një aplikimi. Seksioni që shtjellon identifikimin e problemit do të shqyrtohet me kujdes në të gjitha hapat e procesit të vlerësimit dhe në rast se një koncept-ide nuk paraqet një formulim dhe analizë të qartë të problemit dhe/ose Bordi i Granteve nuk është i kënaqur me shpjegimet e aplikuesit gjatë Konkursit të Ideve, atëherë aplikimi nuk mund të konsiderohet si një ide e vlefshme. Nga aplikanti do të kërkohet që të paraqitet në mënyrë të qartë



LEVIZAlbania
Demokracia Vendore në Veprim



#RUAJDISTANCËN #VENDOSMASKËN

ndërlidhja mes identifikimit të problemit në fazën e parë të koncept-idesë dhe analizës së bërë në projektpropozimin e plotë. Kjo ndërlidhje do të jetë objekt vlerësimi nga Bordi i Granteve gjatë Konkursit të Ideve.

Gjatë fazës së përgatitjes së projektpropozimeve të plota, LevizAlbania do të zhvillojë sesione orientimi për aplikantët e kualifikuar, lidhur me kërkesat që duhet të plotësojnë për paraqitjen e projektpropozimit të plotë. Gjithashtu LevizAlbania do të organizojë, gjatë kësaj faze, disa workshope tematike, referuar instrumentave institucional që janë në dispozicion të aktorëve të shoqërisë civile dhe qytetarëve për të nxitur ndërveprimin e tyre me qeverisjen vendore. Workshopet e planifikuara përfshijnë të drejtën e informimit, masat kundër diskriminimit, angazhimin rinor, etj.

8. E Drejta e Ankimimit

Aplikuesi ka të drejtën e paraqitjes së një ankese, e cila duhet të bëhet jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e dërgimit të informacionit me shkrim nga LevizAlbania. Ankesa duhet të dërgohet me shkrim (email ose postë) nga vetë aplikanti dhe të përshkruajë qartë argumentet për ankimimin. Përgjigja i dërgohet ankimuesit jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga përfundimi i afatit të ankimimit.